



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226021

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06013482

AC-I-23-0219-A0001-A0002

Në çështjen juridike të :

Paditësi/ankuesi

Sh R nga fshati R i Komunës së Shtimes, e të cilin e përfaqëson av. B I nga Prishtina.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

N.SH. "Magjistrala" (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe paditësit të paraqitura kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0336, të datës 28 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.**
- 3. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-22-0336, i datës 28 mars 2022 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN032-0080 i datës 06 qershor 2013.**
- 4. Obligohet e paditura AKP, që paditësit Sh R në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën janar 2006 deri në maj 2007, t'i**

paguaj shumën prej 4,504.00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 450.40 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit në shumë prej 208 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës së paditësit në shumë prej 888.00 euro, refuzohet si e pa bazuar.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 10 korrik 2013, paditësi, ish punëtor i NSH-së "Magjistrala" në Prishtinë e ka dorëzuar një ankesë të përbashkët me ankuesit tjerë, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Magjistranja" në Prishtinë PRN032-0080 të datës 06 qershor 2013 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim e pagave të papaguara për periudhën janar 2006 – maj 2007, në shumën totale prej 5,392.00 euro nga NSH- "Magjistrala" në Prishtinë. Kjo ankesë e përbashkët në bazë të urdhrit të gjykatës është ndarë, andaj avokati i paditësit me datë 30 shtator 2015, e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe bënë ndarjen dhe plotësimin e ankesës, e cila regjistrohet me numrin C-IV.-15-1847. Paditësi në ankesë pohon se në NSH "Magjistranja" në Prishtinë ishte në marrëdhënie të përhershme pune dhe kishe dokumentacion të mjaftueshëm, që atij t'i paguhen pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH-së. Paditësi, konsideron se e paditura nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie pune të rregullt dhe të përhershme në NSH "Magjistrala". Për këtë ekziston dokumentacioni i mjaftueshëm, mirëpo përkundër kësaj është refuzuar kërkesa për pagesat e pagave, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar si dhe ka kërkuara kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit.

E paditura AKP-ja përmes mbrojtjes në ankesë të dt. 11 prill 2014, pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit që ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka pohuar se ankesa e paditësit është e papranueshme pasi që është e pa afatshme nëse merret në konsideratë se paditësi ankesën e ka paraqitur me datë 30 shtator 2015. Prandaj parashtresa për rregullimin e padisë e datës 30

shtator 2015 është dorëzuar më tepër se dy vjet pas kalimit të aftit dhe si e tillë është e pa pranueshme dhe pa asnjë vlerë ligjore. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit duke i përmbushur përgjegjësitë e veta ligjore, ka kërkuar së pari prej paditësit e pastaj edhe prej burimeve të tjera, prova për përcaktimin e të drejtës në kompensimin e pagave të pa paguara, ndërsa Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se një grup i ish punëtorëve të NSH-së kanë kryer punë të caktuara për të cilat janë paguar, ndërsa paditësi nuk ka qenë në listën e pagave, andaj ajo nuk ka punuar në NSH-ë. Tutje AKP-ja pohon se do të ishte padrejtësi që të paguhen ish punëtorët me grupin e punëtorëve që kanë punuar në NSH. AKP-ja po ashtu pohon se paditësi kishte për detyrë ta provojë me prova kërkesën e tij pastaj duke mbledhur provat e nevojshme për sqarimin e situatës dhe gjetjen e së vërtetës mbi të drejtën e ankuesit për kompensimin e kërkuar. Mirëpo Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se dokumentacioni i ofruar nuk ishte i plotë, andaj ka vendosur ta refuzojë kërkesën. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1847 të dt. 07 qershor 2021, e ka refuzuar si të pabazuar aneksen e paditësit dhe ka vetëtuar vendimin e AL PRN032-0080 të dt. 06 qershor 2013, me arsyetimin se paditësi nuk ishte arritur të dorëzoj prova të mjaftuara për të provuara të drejtën e tij për pagat e kërkuara.

Kundër aktgjykimit C-IV-15-1847 të dt. 07 qershor 2021, paditësi kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS, ku paditësi ka bashkangjitur prova të reja si njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe përmbledhjen mujore të pagave të punëtorëve të NSH "Magjistranja" për periudhën kohore të pretenduar, siç janë librezat e punës, formularin e kërkesës dorëzuar në AL, një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën janar 2005 -prill 2007, mbi bazën e të cilave është aprovuar ankesa e paditësit me aktvendimin, AC-I-21-0470-A0001 të dt. 13 tetor 2022, dhe ishte anuluar aktgjykimin, C-IV-15-1847 dt. 07.06.2021 dhe çështja është kthyer në rigjykim dhe se në rigjykim lënda është evidentuar si, C - IV - 22 - 0336.

Me 28 mars 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0336 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit PRN032-0080 të dt.06.06.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të njëjtin e ka

ndryshuar dhe e ka obliguar Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, në emër të tre pagave të papaguara t'ia kompensoj shumën prej 844.50 €, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në shumën prej 84.45 €. Ndërsa ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpapia e paditësit, për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 4,547.50 € si dhe normën e kamatës prej 3.5% dhe 8% në vit në periudha të cilat e kishte kërkuar paditësi. I ka njohur paditësit shpenzimet e procedurës gjyqësore për padinë e ushtruar nga i autorizuari i tij dhe atë shumën prej 104.00 € (një qind e katër).

Shkalla e parë ka arsyetuar se nuk ishte kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse ka qëndruar raportin juridik i marrëdhënies së punës në mes të paditësit dhe NSH "Magjistranja" në likuidim, për të cilën kjo konstatohet me librezën e punës të dt. 24.11.1976, si dhe nuk është kontestuese se me shkresën e dt. 22 maj 2007, të lëshuar nga AKM, parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të likuidimit të NSH-së, por në mes të palëve kontestuese ishte çështja e parashkrimit të kërkesës së pagave. Tutje shkalla e parë nuk e kishte marrë si të drejtë dhe të plotë qëndrimin juridik të paditurës me rastin e refuzimit të kërkesës së parashtruesit pasi që AL-ja, gabimisht ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 36.2.21 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP.

Shkalla e parë kishte konstatuar se sipas librezës së punës paditësi kishte qenë në marrëdhënie pune tek NSH "Magjistranja" deri në pranimin e njoftimit të dt. 22 maj 2007, të lëshuar nga AKM, me të cilën e njofton paditësin se marrëdhënia e punës së tij përfundon menjëherë dhe se kërkesat për paga të papaguara do të shqyrtohet në procedurë të likuidimi, nga regjistri përmbledhja mujore e rrogave të punëtorëve për periudhën kohore të pretenduar të llogaritura dhe të miratuar nga drejtori i NSH, "Magjistranja" në likuidim, evidenton pagën mesatare mujore prej 281.50 euro, andaj e kishte konsideruar si të drejtë pranimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e 3 (tri) pagave të papaguara e në shumë të përgjithshme prej 844.50 euro, duke u bazuar në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP se :*"Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person"* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjti nen 40, si dhe se lidhur me kamatën ligjore, duhet të zbatohet dispozita e nenit 37. 3

të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në e në të cilën thuhet se: *“Të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*. Ndërsa duke u bazuar në dispozitat e cituara më lartë, pjesërisht ia refuzoj kërkesëpadinë e paditësit lidhur me pjesën tjetër për kompensimin për pagat e pa paguara në shumës prej 4,547.50 € dhe për normën e kamatës nga data 01.01.2008, e deri me datën 19.12.2012, në shkallën prej 3.5 % në vit në shumën prej 943.60 € ndërsa për periudhën prej dt.19.12.2012, duke filluar prej hyrjes në fuqi të Ligjit të LMD-së e me kamatën prej 8 % në vit, në shumën e tërësishme prej 1,186.24 € dhe shumën tjetër të kamatës në të njëjtën lartësi e deri në pagesën e plotë e në shumën e tërësishme të kamatës deri më dt.22.09.2015 prej 2,129.84 €.

Me 13 prill 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-22-0336 të datës 28 mars 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të refuzohet ankesa ndaj vendimit të AL-së si e pabazuar duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë Autoriteti i Likuidimit thekson se NSH-ja nuk e konsideron një person aktiv nëse ai nuk e ka e ka vërtetuar se ka punuar pranë NSH-ve për periudhën që pretendon kompensim të pagave. Autoriteti i Likuidimit gjatë shqyrtimit të kërkesës është shërbyer me informacione të mbrendshme dhe të jashtme dhe në baze të saja se qka ka arritur të vërtetohet e ka refuzuar kërkesën. Në këtë rast AL-ja ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit për periudhën Janar 2006- dhjetor 2007, nga të cilat rezulton se parashtruesi i kërkesës ka punuar ore efektive pune me NSH-në në muajt Janar-Prill 2006. Nga të cilat rezulton se parashtruesi nuk figuron si një i punësuar i NSH-së pas muajit dhjetor 2005. Në lidhje me këtë konstatim, Autoriteti i Likuidimit thekson se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të pa drejtë. Pasi që parashtruesi nuk ka arritur dokumentacionet dhe dëshmitë e nevojshme në lidhje me kërkesën, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike nga e cila rezulton se nuk figuron si një i punësuar pranë NSH-së në muajt dhjetor 2005. Në këtë rast AL-ja e ka refuzuar kërkesën i si të pa pranueshme sepse parashtruesi nuk ka arritur të provojë me fakte meritën e kërkesës së tij.

Më 18 prill 2023, paditësi (ankuesi) ka parashtruar një ankesë kundër Aktgjyqimit C-IV-22-0336 të datës 28 mars 2023, për shkak të gjitha arsyeve ankimore duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet pika e II e aktgjyqimit të ankimuar dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e borxhit kryesor në shumën prej 5,392.00 euro, si dhe kamatë vonesën si dhe shpenzimeve të përfaqësimit në baze Tarifës së Odës së Avokatëve. Në ankesë ka shtuar se NSH-ja i ka mbetur mbetur borgj dhe kjo dëshmohet nga Lista e pagave. Këto Lista specifikonte në mënyrë të qartë titullarin dhe numrin e pagave dhe lartësinë e pagës. Lista është hartuar dhe e nënshkruar nga personat kompetent në ndërmarrje të cilat edhe janë propozuar si dëshmitarë në këtë kontest. Listat e pagave të cilat janë përpiluar protokolluar, nënshkruar dhe vulosur për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore nuk janë miratuar nga AKM-AKP-ja por nga menaxhmenti i NSH-së. Siç shihet edhe nga listat e pagave të cilat i kemi bashkangjitur edhe një herë si provë për të dëshmuar obligimin e pa përmbushur nga e paditura ndaj paditësit shihet qartë se lista përmban kategoritë se si janë përlllogaritur dhe faturat pagat e pa paguara po të njëjtat nuk janë ekzekutuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe jo kërkesa lidhur me tri paga sepse një kërkesë e tillë hyn në një kategorizim tjetër. Po ashtu paditësi (ankuesi) ka shtuar se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i cili është dërguar paditësit nga AKM-ja është dëshmia se ai punonte dhe realizonte të ardhura nga ky punëdhënës. Paditësi me këtë dëshmi se ai punonte dhe realizonte të ardhura nga ky punëdhënës. Paditësi me këtë dëshmi ka vërtetuar një fakt të pa kontestuar se ai ishte punëtor i NSH-së deri më datën 22 maj 2007 deri kur atij duhet ti paguhen pagat e mbetura borxh dhe i cili borxh është njohur duke u përfshirë atë në Listën e pagave. Ankesës ja ka bashkangjitur Librezën e punës dhe listën e pagave për vitin 2006 deri në qershor 2007.

Me 05 mars 2024, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit e kishte parashtruar përgjigje ndaj ankesës me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar , ndërsa Kolegji i Apelit të vendos sipas ankese së paraqitur nga përfaqësuesi i paditësit duke propozuar që të ndryshohet pik e II e aktgjyqimit të ankimuar dhe po ashtu të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në baze Tarifës së Odës së Avokatëve. Paditësi në përgjigjen në ankesë ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për vlerësimin e situatës faktike në mënyrë të gabuar pasi që gjykata e shkallës së parë

ka administruar dhe ka nxjerrë të gjitha provat e propozuar të cilat i ka konsideruara si të nevojshme për të vërtetuar faktet vendimtare të çështjes të cilat të kualifikuara në raport me normat materialo-juridike kanë përcaktuar që kërkesëpapia është e bazuar dhe vlerësuar në mënyrë specifike, prandaj pretendimi i të paditurës se gjykata e ka vlerësuar situatën faktike në mënyrë të gabuar është një pretendim i pa bazuar. Dokumentet të cilat janë dorëzuar para marrjes së vendimit të shkallës së parë siç është njoftimi për pushimin e marrëdhënies së punës i datës 22 maj 2007 ka vërtetuar faktin se e paditura ka lëshuar dokumentin e njoftimit të rëndësishme për paditësin me të cilin e ka njoftuar se Ndërmarrja ka hyrë në procedurë të likuidimit. Në bazë të këtij njoftimi është theksuar se shumat e parave duke përfshirë edhe të gjitha pagat e pa paguara të cilat ende ua ka borxh e paditura sipas kontratës do të trajtohen në procedurë të likuidimit. Me anë të njoftimit të datës 16 korrik 2007 drejtori i NSH" Magjistratja" duke u përgjigjur në shkresën e AKM me nr.19 të datës 10 korrik 2007 ka dorëzuar të gjithë regjistrat punëtore për të gjitha njësite punuese të kësaj NSH-je. Në bazë të këtyre regjistrave janë dhënë sqarime për të gjitha ndalesat në të ardhurat personale si ato të trustit Pensional të Kosovës dhe të cilat janë të paguara të cilat vetëm të deklaruar e të pa paguara. Pra siç shihet nga dokumenti i dorëzuar si provë në DHPGJS i cili është noterizuar dhe dëshmon saktë se të gjitha listat për periudhat kontestuese i janë dorëzuar të paditurës lidhur me punëtorët aktiv deri në ditën kur punëtorët kanë pranuar njoftimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Po ashtu me provat siç janë Listat e pagave për periudhën kontestuese janë nënshkruar nga personat kompetent ku shihet se paditësi Sh R është radhitur në numrin 6 dhe është i përfshirë në Listën e Pagave të njësisë Caralevë. Sipas kësaj liste shihet qartë se paditësi ka qenë punëtor aktiv deri në momentin kur e paditura në bazë të njoftimit e ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Po ashtu sa i përket çështjes së personave kompetent lidhur me llogaritjen e pagave, përpilimin e tyre si dhe nënshkrimin para marrjes së vendimit të shkallës së parë janë bashkangjitur dëshmitë siç janë: Deklarata nën betim të dhënë para noterit të drejtorit të NSH-së Sh P si dhe kontabilistit A K ku në bazë të kësaj deklarata të njëjtit vërtetojnë se në bazë të akteve të mbrendshme dhe pozitave të tyre kanë qenë kompetent për përpilimin dhe nënshkrimin e këtyre listave. Ka shtuar se qëndrimi i Shkallës së parë është i drejtë , mirëpo ashtu siç ka cekur në ankesën e tij të paraqitur kundër aktgjykimit , shkalla e parë gabimisht ka bërë zbatimin e gabuara të së drejtës materiale në momentin e pranimit të kërkesës së paditësit lidhur me kërkesën për

tri paga dhe jo për paga të papaguara të cilën ankuesi ka pasur kërkesën e tij që tek AL.

Më 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditëses duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës-AKP-së, është e pabazuar, ndërsa ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, nuk është plotësisht i saktë dhe i drejtë, andaj i njëjti duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi kishte parashtruar kërkesë tek AL më 12 korrik 2007, me të cilën ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguar në shumë prej 5,392.00 euro, për periudhën janar 2006-maj 2007, gjithsejtë 16 paga. Me vendimin e AL PRN032-0080 kërkesa ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se në bazë të listës së pagave dhe evidencave të ndërmarrjes, parashtruesi nuk rezultoi të ketë ofruar shërbime për ndërmarrjen dhe nuk figuron si një i punësuar pran NSH-së pas muajit dhjetor 2005.

Me 28 mars 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0336 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit PRN032-0080 të dt.06.06.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të njëjtin e ka ndryshuar dhe e ka obliguar Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, në emër të tre pagave të papaguara t'ia kompensoj

shumën prej 844.50 €, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në shumën prej 84.45 €. Ndërsa ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpapia e paditësit, për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 4,547.50 € si dhe normën e kamatës prej 3.5% dhe 8% në vit në periudha të cilat e kishte kërkuar paditësi. I ka njohur paditësit shpenzimet e procedurës gjyqësore për padinë e ushtruar nga i autorizuari i tij dhe atë shumën prej 104.00 € (një qind e katër). Shkalla e parë e kishte konsideruar si të drejtë pranimin e pjesërisht të kërkesë së paditësit për kompensimin e 3 (tri) pagave të papaguara e në shumë të përgjithshme prej 844.50 euro, duke u bazuar në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP se të kufizuar në tri paga mujore bruto për person si dhe kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi dhe e paditura ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit.

Paditësi në ankesën e tij pretendon se atij i takojnë pagat e papaguara në shumën prej 5,392.00 euro nga NSH- “Magjistrala” (në likuidim) Paditësi në Shkallës së I-rë kishte paraqitur listën e pagave të punëtorëve të N.Sh-së të papaguara, librezën e punës e mbyllur me dt. 13 prill 2007, letër pezullimin e dt. 22 maj 2007, formularin e kërkesë të paraqitur tek AL për pagat e papaguara, dhe një përmbledhje mujore të pagave të punëtorëve të NSH-së për periudhën shtator 2006 – qershor 2007.

E paditura në ankesën e saj konsideron se paditësi nuk figuron si një i punësuar i NSH –së pas muajit dhjetor 2005. Në lidhje me këtë konstatim, Autoriteti i Likuidimit thekson se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të pa drejtë, pasi që parashtruesi nuk ka arritur dokumentacionet dhe dëshmitë e nevojshme në lidhje me kërkesën e tij.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësi me provat e ofruara ka dëshmuar se atij i takojnë pagat e papaguara për periudhën per periudhën janar 2006 – maj 2007, në shumën totale prej 5,392.00 euro nga NSH- “Magjistrala” në Prishtinë.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë sa i përket vlerësimit të gjendjes faktike, sepse vërtet nuk është kontestuese se paditësi ishte i punëtor i NSH-së, deri në kohën kur paditësit AKM i kishte ndërpre punësimin me letër pezullimin e dt. 22 maj 2007, por shkalla e parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale duke zbatuar dispoziten e nenit 40.1.1.6.1 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP se të kufizuar në tri paga mujore bruto për person dhe paditësit i kishte njohur pjesërisht vetëm tri paga të papaguara, ndërsa nga provat të cilat gjenden në shkresat e lendes, vërehet qarte se paditësi që nga paraqitja e kërkesë tek AL kishte kërkuar kompensimin për 16 paga të papaguara e jo 3 paga.

Kolegji i Apelit vëren se nga lista e pagave që i përket periudhës janar 2006 deri qershor 2007, shihet se emri i paditësit figuron në numrin rendor 6 dhe se mesatarja mujore ishte prej 281.50 euro, në muaj për periudhën janar 2006 - prill 2007. Nga përmbledhja e mujore e pagave të punëtorëve të NSH "Magjistralaja" të nënshkruara nga llogaritari dhe drejtori i NSH-së, vërtetohet se paditësi kishte paga mujore neto në lartësi prej 281.50 euro, ku gjithsejtë paditësi për periudhën nga janari 2006- maj 2007 kishte paga të papaguara në lartësi prej 4,504 euro ($281.50 \text{ euro} \times 16 = 4,504 \text{ €}$), andaj paditësit i njihet kjo shumë. Kërkesa tjetër përtej shumës së aprovuar e që është 888.00 euro, refuzohet për shkak se nuk është mbështetur në prova në nevojshme materiale.

E paditura përveç perëndimeve nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën me prova mbështetëse se paditësit i ka paguara pagat e kërkuara, andaj në këtë aspekt perëndimet e saj të ngritura përmes ankesës dhe përgjigjes ndaja ankesës se paditësit janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 450.4 euro , ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është aprovuar pjesërisht si e bazuar, dhe është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkalles se I-rë i DHPGJS dhe vendimi i AL, ndërsa ankesa e të paditurës –AKP-së refuzohet si e pabazuar .

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja /Ankuesja dhe Paditësi / ankuesi tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
